



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
SEKTORI I SHERBIMIT TE MZSH-SE

Adresa : Sheshi "Lord Bajron"

email: info@tepelena.gov.al

Nr 1051/ Prot

Tepelene, me 28 . 06 .2025

Lenda: Informacion

Mbi masat e marra nga Sektori i Sherbimit te MZSH-se per parandalimin e zjarreve si dhe bashkepunimi me Emergjencat Civile gjate sezonit turistik ne territorin e Bashkise Tepelene.

Drejtuar : Keshillit Bashkiak Tepelene

Te nderuar perfaqesues te Keshillit Bashkiak!

Ju falenderojme qe merrni ne analize Sherbimin Zjarrfikes ne Bashkine tone, eshte vleresim qe i behet ketij lloj Sherbimi ne komunitetin tone, por ne radhe te pare eshte nje pergjegjesi per ne, per te permbushur me se miri detyrimet ligjore qe rrjedhin nga Ligji 152/ 2015 " Per Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpetimin". Vlen te citojme se :

Sherbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimin (MZSH) eshte Strukture e specializuar e gatishmerise se perhershme.

- Misioni i ketij Sherbimi eshte inspektimi, parandalimi me masat e mbrojtjes nga zjarri, nderhyrja per shuarjen e zjarreve, shpetimin e jetes, gjese se gjalle, prones, mjedisit, pyjeve dhe kullotave, aksidentet e ndryshme, fatkeqesi natyrore si dhe ato te shkaktuara nga dora e njeriut.

- Sherbimi i MZSH-se eshte institucion i administrates publike, me status te vecante.

- Statusi i punonjesit te Sherbimit te MZSH-se rregullohet:

a) Sipas ketij ligji per punonjesit e Sherbimit te MZSH-se me grada

b) Sipas kodit te punes per punonjesit administrativ

- Statusi i Sherbimit nuk ndryshon edhe ne gjendje lufte, gjendje te jashtezakonshme apo fatkeqesi natyrore.

- Neni 7 i ligjit te siperpermendur per organizimin e struktures se Sherbimit te MZSH-se ne nivel vendor eshte ne vartesi te Kryetarit te Bashkise. Ajo perfaqeson strukturen baze operuese dhe inspektuese ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin ne territorin qe ajo ka ne juridiksion. Me tej ne ligj citohet se : Cdo Bashki duhet te mbuloje territorin e saj me Sherbimin Zjarrfikes, me stacione te kompletuara me personel, automjete dhe pajisje zjarrfikese.

- Ky lloj Sherbimi ne Bashki ngrihet duke zbatuar Standartin 1 zjarrfikes profesionist per 1500-2000 banore dhe thekson me tej : Cdo stacion duhet te kete jo me pak se 14 zjarrfikes personel profesionist. Kjo te ne funksionon konform ligjit.

- Po keshtu ne vijimesi ligji per kete lloj Sherbimi percakton edhe pergjegjesite qe ka Bashkia



per funksionimin e ketij lloj sherbimi ne komunitet.

I permenda keto paragrafe te ligjit per faktin se Sherbimi Zjarrfikes eshte i deleguar ne Bashki.

- E pikerisht puna e Sherbimit Zjarrfikes ne Bashki per kete periudhe te cilen po analizojme ka filluar qe ne fillim te vitit, me njohjen e ligjit, urdhrave dhe udhezimeve te ardhura nga MPB dhe Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimit Zjarrfikes ne kete Ministri, me perpilimin e programit te punes per Sektorin tone i miratuar dhe nga Kryetari i Bashkise, i cili eshte i detajuar me te gjitha problematikat qe mbulon ky lloj Sherbimi.

- Prioritet i punes ne kete Sektor ka qene edhe marrja e masave paraprake per parandalimin e zjarreve ne objekte me rrezik te theksuar zjarri, ne pika karburanti e gazi, ne banesa, objekte te ndryshme private e shteterore.

- Per periudhen te cilen raportojme duke u bazuar ne statistiken qe disponon Sherbimi Zjarrfikes ne Bashki rezulton se : Per periudhen Janar- Qershor jane regjistruar gjithsej :

- 17 akte kontrolli dhe rikontrolli per parandalimin e zjarreve ne subjekte te ndryshme private e shteterore.

- Jane regjistruar gjithsej 8 raste zjarresh, nga keto :

2 zjarre ne banesa private, shtepi banimi

3 zjarre ne automjete private

3 zjarre ne gjerdhe, ledhe, barishte e plehra etj

- Kemi nderhyre ne 2 raste per shpetim te turisteve te huaj.

-Kemi nderhyre ne 4 raste ne zhblokimin e dyerve ne banesa private per shkak te bllokimit (mbylljes) se dyerve nga pakujdesia dhe bllokimin e njerezve brenda, kryesisht pleq (te moshuar).

- Periudha ne te cilen futemi Korrik- Gusht- Shtator per sherbimin tone per shkak te temperaturave te larta te veres dhe manise per te pastruar e djegur kullotat, per ne eshte nje periudhe me ngarkese te larte pune. Per keto ne si sherbim kemi marre te gjitha masat per perballimin e kesaj situate.

-Eshte hartuar plani i masave per bashkerendimin dhe bashkeveprimin me te gjitha strukturat e Bashkise, por edhe me strukturat e tjera si, Komisariati i Policise, pyje e kullota, mjedisi, Administrates Rajonale te zonave te mbrojtura Gjirokaster, etj si ne Bashki edhe me tej ne rang Qarku, program ky i miratuar edhe nga Kryetari i Bashkise.

- Ne mbeshtetje te ketij programi jane bere takime sensibilizuese me te gjitha aktoret e vecanerisht me kryetaret e Njesive Administrative, me kryetaret e fshatrave per sensibilizimin e banoreve per parandalimin e zjarreve ne periudhen e nxehte te veres.

- Nje ndihmese te madhe per masat e marra per parandalimin e zjarreve ne pyje e kullota na eshte dhene nga Bashkia duke vendosur ne cdo Njesi Administrative vrojtues-sinjalizues per periudhen e nxehte te veres.

- Jane vene ne gatishmeri te plote 2 automjetet zjarrfikese si dhe 1 kamioncine, dhe gjithte baza materiale e nevojshme per kete stine. Po keshtu bazen materiale duke e krahasuar me nje vit me pare, vleresojme se e kemi permiresuar shume, perkushtimi dhe gatishmeria e efektivit zjarrfikes eshte per t'u vleresuar fale edhe mbeshtetjes qe na ka dhene Bashkia per plotesimin e nevojave te

Sherbimit Zjarrfikes gje qe ka rritur performancen tone ne permbushjen e misionit qe na ngarkon ligji, gje qe e kemi treguar ne zjarrin e rene ne kuroren e Tepelene si dhe ne zonen e Lopsit e cila ka qene nje situat e veshtire per punonjesit e MZSH-se.

- E megjithë masat e marra për të përballuar situatat e zjarreve dhe sidomos në muajt e nxehtë të kesaj vere, por edhe në vazhdimësi kemi plot mangesi të cilat duhet të permiresojme e të mbeshetemi edhe me shume gje qe e kerkojme edhe nga ju të nderuar Keshilltare.

- Stimulimi i efektivitetit zjarrfikes me fonde të shperblime është shume efektiv, gje qe e ndiejme në punën tonë.

- Ndertimi i brezave pyjor në zonat me pyje e me gjelberim është tjetër shqetesim.

- Kualifikimi i metejsheëm që i duhet bërë efektivitetit zjarrfikes në kurse trajnimi si brenda vendit ashtu edhe jashtë vendit ashtu sic bëjnë edhe vendet fqinje, për ne si drejtues të këtij sherbimi mendojme se është domosdoshmeri, edhe pse këtë muaj u zhvillua një stervitje komplekse, ku moren pjesë edhe Sherbimi ynë Zjarrfikes dhe Emergjencat Civile në Gjirokastër, gje qe ishte shume efektive për ne.

- Identifikimi i zjarrvrenesve është i veshtirë pasi shume kullota janë pa kontratë, pa pronar.

- Rojet e pyllit e të kullotave duhet të jenë me të angazhuar në punë sidomos për periudhën e nxehtë të verës.

Keto ishin disa nga problemet që mund të raportojmë të ju, të nderuar anetare të Keshillit Bashkiak, në vazhdimësi të punës sonë kerkojme edhe ndihmën tuaj si njëzë të përzgjedhur nga komuniteti ynë.

Ju garantojme se pavarësisht ndonjë veshtiresie në, si Sherbim Zjarrfikes do të jemi të perkushtuar për t'ju përgjigjur të gjitha detyrimeve që na ngarkon ligji në misionin e vet për MZSH-ne.

Ju faleminderit!

Per Sektorin e Sherbimit të MZSH-se

Bashkia Tepelene

Insp/ Xhevit Mana

